



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

29.01.2008

Të gjitha Kompanitë Regjionale për Grumbullimin e Mbeturinave

Attn: Të gjithë Drejtorëve të Kompanive

Procesi i Konsultimit për:

Amendamentet e Propozuara të Rregullës së ZRRUM-it për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave

Të nderuar,

Kuadri aktual ligjor për rregullativën ekonomike të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë i përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49, siguron pozitë monopoli për Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore të licencuara në ofrimin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave.

Duke pasë parasysh praktikat e mira në vendet tjera Europiane si dhe karakteristikat e sektorit të mbeturinave (që nuk është shërbim me karakter të monopolit natyror dhe që është i përshtatshëm për konkurrencën e tregut në nivel të komunës), **ZRRUM ka propozuar de-rregullimin e plotë të aktiviteteve të grumbullimit të mbeturinave** që aktualisht rregullohen dhe licencohen nga ZRRUM-i si zgjidhje më e mirë afatgjatë për futjen e konkurrencës me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Ky propozim afatgjatë është përshkruar në një dokument për Participimin e Sektorit Privat që është hartuar dhe shpërndarë për konsultim tek palët kryesore të interesit në prill të vitit 2007. De-rregullimi i aktiviteteve “kryesore” të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është komponenta kryesore e propozim Ligjit të ZRRUM-it që pritet të zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 së pasi të jetë proceduar në procedurën e aprovimit në Kuvendin e Kosovës.

Shembulli më domethënës i monopolit artificial në shërbimet e grumbullimit të mbeturinave janë shërbimet “dytësore” që kanë të bëjnë me grumbullimin e mbeturinave siq janë pastrimi i rrugëve, grumbullimi i materialeve ndëtimore etj. të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë specifike në legjislacionin primar, pra në rregulloren 2004/49, por që sipas Rregullës së ZRRUM-it për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, janë pjesë e aktiviteteve të rregulluara të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, prandaj edhe janë objekt i licencimit nga ana e ZRRUM-it. Meqenëse ZRRUM ka mandat ligjor që të licencojë vetëm ndërmarrjet publike dhe shoqërore kjo do të thotë se në praktikë vetëm kompanitë publike të licencuara nga ZRRUM mund të ofrojnë shërbimet “kryesore” të grumbullimit të mbeturinave si dhe shërbimet “dytësore” (pastrimin

e rrugëve etj.), duke pamundësuar kësisoji çfarëdo konkurrence në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Duke marrë parasysh zhvillimet në sektorin e mbeturinave në vitet e fundit dhe në veçanti duke marrë parasysh:

- (i) problemet praktike që dalin nga pakënaqësia e komunave me nivelin e shërbimit lidhur me aktivitetet “dytësore” (veqanërisht me pastrimin e rrugëve) që ofrohen nga ndërmarrjet publike të licencuara që operojnë në kushtet e monopolit, dhe
- (ii) (ii) dispozitat e Rregullores 2004/49 e cila nuk përcakton në mënyrë specifike se ZRRUM duhet të licencojë vetëm ndërmarrjet publike për ofrimin e shërbimeve “dytësore”,

ZRRUM ka ndërmend ta amendamentojë Rregullën për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave (Rregulla e Licencimit) në atë mënyrë që të laergojë të gjitha aktivitetet “dytësore” nga aktivitetet e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave që i nënshtrohen rregullimit dhe licencimit nga ana e ZRRUM-it (duke sghlyer paragrafët (b), (c), (d), (e), dhe (f) nga Neni 6 i kësaj Rregulle).

Duhet të theksohet Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 i definon shërbimet e grumbullimit të mbeturinave si “grumbullim i Mbeturinave Komunale dhe transportim i tyre në Deponi”. Prandaj i vetmi aktivitet që do të licencohet dhe rregullohet nga ZRRUM-i pas amendamentimit të Rregullës së Licencimit që ZRRUM planifikon ta zbatojë prej 1 Janarit 2008, do të jenë aktiviteti “kryesor” i grumbullimit të mbeturinave komunale dhe transportimi i tyre në Deponi.

Aktivitet “dytësore” që do të shlyhen me amendamentimin e Rregullës, janë si vijon:

- b) grumbullimi, largimi dhe transportimi i mbetjeve, ose mbeturinave që rezultojnë nga ndërtimet dhe/ose aktivitetet e demolimit, operacioneve të pastrimit të terrenit, ose rehabilitimit të ndërtesave;
- c) grumbullimi, largimi dhe transportimi, për qëllime të ri-ciklimit të materialeve të mbetura jo-toksike, dhe jo-hazarde nga entitetet komerciale, publike ose institucionet ndërkombëtare, përfshirë edhe institucionet ushtarake;
- d) grumbullimi, largimi dhe transportimi i mbetjeve ose mbeturinave që rezultojnë nga punimet tokësore;
- e) grumbullimi, largimi dhe transportimi i mbetjeve ose mbeturinave që rezultojnë nga aktivitetet e pastrimit të rrugëve;
- f) që kanë të bëjnë me rritjen e fondeve përmes grumbullimit, largimit dhe transportimit të mbeturinave përfshirë mbeturinat e ndara në burim, ose produktet tjera të mbeturinave komunale.

Amendamentet e planifikuara të Rregullës së Licencimit do të mundësojnë konkurrencën në ofrimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve dhe të aktiveve tjera “dytësore” për të parën herë dhe do të iu mundësojnë Komunave opcionin e angazhimit të operatorit (qoftë publik ose privat) për kryerjen e këtyre shërbimeve përmes procesit të thjeshtë të tenderit të hapur.

ZRRUM beson se amendamentet e propozuara do të prodhojnë ngritjen e cilësisë së shërbimeve të pastrimit të rrugëve dhe shërbimeve tjera “dytësore” në dobi të të gjithë qytetarëve, dhe si rezultat i adoptimit të qasjes së konkurrencës poashtu edhe eliminimin e pengesave artificiale të panevojshme karshi konkurrencës së tregut.

Në afat të gjatë ZRRUM pret që të gjitha aktivitetet e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave komunale do të de-rregullohen plotësisht në aspektin e rregullativës ekonomike (në kuptim të rregullimit nga ana e autoritetit rregullator) dhe ti nënshtrohen rregullimit përmes mekanizmave të tregut. Kjo pritet të ndodhë me aprovimin e Ligjit të ZRRUM-it.

Dëshiroj të nënvizojë se amendamentimet e propozuara në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në kontratat ekzistuese ndërmjet komunave dhe kompaniove publike të mbeturinave, të cilat kontrata duhet të zbatohen në përputhje me dispozitat kontraktuale të dakorduara ndërmjet palëve.

ZRRUM do të mirëpres komentet e juaja të cilat do të mirren parasysh me kujdes para se ZRRUM të marrë vendimin final lidhur me këtë çështje të rëndësishme. Ne do të ju ishim shumë mirënjohës nëse do ti dërgonit komentet e juaja lidhur me amendamentimin e propozuar deri më 15 Shkurt 2008.

Me respekt,



Afrim Lajci
Drejtore I ZRRUM-it